



Raport nga pjesëmarrja në vizitën studimore në Mbretërinë e Bashkuar

**Vizita studimore
në Mbretërinë e Bashkuar**

08-15 Nëntor 2012

Luan Nushi

Instituti për Planifikim Hapësinor
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Vendi:	Mbretëria e Bashkuar (MB) Lacock, Bath, Cearphuly, Stonehange, Avebury dhe Londër
Data:	08 – 15 Nëntor 2012
Organizatori:	CHwB - Trashëgimia Kulturore pa Kufij Programi – “Planet Lokale të Trashëgimisë Kulturore 2012-2015”
Pjesëmarrës:	Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Përfaqësues të komunave pjesëmarrëse (Gjakovë, Vushtrri, Gjilan, Dragash, Partesh, Kaçanik dhe Rahovec), si dhe përfaqësues të CHwB-së të përkrahur nga përfaqësuesja e National Trust-it;



Fig. Të renditur nga e majta: **Luan Nushi**, Drejtor - Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH); **Idriz Ismajli**, Drejtor - Departamenti i Kulturës, Komuna e Vushtrrisë; **Nol Binakaj** – Menaxher projekti, Zëvendës shef i zyrës – Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB); **Milot Mustafa** – Udhëheqës i divizioni të për Trashëgimi të Luajtshme dhe Shpirtërore, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS); **Bekim Troni**, Drejtor - Departamenti Urbanizmit, Komuna e Kaçanikut; **Veton Nevzadi**, Drejtor - Departamenti i Kulturës, Komuna e Gjilanit; **Shukrane Begu**, Etnologe - Muzeu historik dhe etnografik i Vushtrrisë; **Mirian Blaci**, Ekspert projekti – Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB); **Leonora Raci**, Drejoreshë - Departamenti Urbanizmit, Komuna e Gjakovës; **Enes Toska**, Menaxher projekti – Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB); **Vergina Dyla**, QRTK Gjakovë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS); **Rachel Nordstrom** - National Trust (NT); **Kamber Kamberi**, Drejtor - Departamenti i Kulturës, Komuna e Dragashit; **Fatmir Kryeziu**, Drejtor - Departamenti Urbanizmit, Komuna e Rahovecit; **Qamil Sahiti**, Drejtor - Departamenti i Kulturës, Komuna e Vushtrrisë; **Todor Ivanovic**, Drejtor - Departamenti Urbanizmit, Komuna e Parteshit; dhe pas kamerës **Senat Haliti** – Menaxher projekti – Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB);

Qëllimi kryesor: Njohja me praktikat ndërkombëtare të mbrojtjes, menaxhimit, promovimit dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Vërejtje: Raporti është resultat i shënimave të marra edhe nga diskutimet e rastit, të cilat në formën se si janë marrë mund të kenë ndonjë pa-korrektësi të vogël. Ndërsa fotot e prezantuara në raport, janë origjinale dhe të realizuara gjatë vizitës në terren.



Të dhëna të përgjithshme për MB

Pak histori

Mbretëria e Bashkuar (MB) përbëhet prej një grapi të ujdhesave në veri-perëndim të Evropës. Është një vend unik i përbërë nga katër shtete: Anglia, Uellsit, Skotlanda dhe Irlanda Veriore. Shënimet tregojnë se jeta në këto anë ka filluar para 10.000 viteve – nga banorët e parë “Picts” të cilët më vonë u dyndën në Skotlandën e sotme nga presioni i keltëve që erdhën nga Evropa. Në vitin 43 të erës sonë MB pushtohet nga Romakët, të cilët për 400 vite sundimi ndërtuan rrugë dhe vendbanime, që përfaqësojnë njérën nga vlerat më të mëdha të trashëgimisë së sotme kulturore. Më vonë, në shekullin e VI ky territor pushtohet nga Jutas, Anglesët dhe Saksonët (popuj gjerman) nga të cilët emërohet Anglia e sotme dhe populli anglez që sot njihet si populli anglo-sakson.

Prej viteve 900 deri në 1400 Anglia sundohet nga popujt skandinav (Vikingët, Normanët dhe Danezët), për të kaluar në mbretëri të bashkuar (1485) në mes Anglisë dhe Uellsit, të udhëhequr nga një mbret i përbashkët Henri i VII-të (Henry Tudor). Në shekullin XVII kësaj mbretërie iu bashkua Skotlanda dhe Irlanda Veriore, e cila më vonë u trashëgua nga mbretëri dhe mbretëresha të rëndësishme, për të ardhur deri në ditët e sotme, kur në fron është e ulur sovrahi Mbretëresha Elizabeta II-të. Në shekullin e XVIII MB është njëri nga shtetet më të fuqishme, e shtrirë përmes kolonive të sajë edhe në disa vende të botës. Një situatë e tillë ndryshon me zhvillimin e luftërave botërore, pas të cilave shumica e kolonive e fitojnë pavarësinë e tyre.



Fig. Në të majtë harta e Mbretërisë së Bashkuar, ndërsa në të djathtë sipër janë flamujt e shteteve që e përbëjnë MB-në (Anglia, Skotlanda, Uellsit dhe Irlanda Veriore) të cilët formojnë flamurin e përbashkët, në të cilin çuditërisht nuk ka asnjë element të flamurit të Uellsit. Ky fakt është edhe një argument shtesë që tregon për kompleksitetin e rregullimit politikë të MB-së.

Rregullimi shtetëror

MB është mbretëri konstitutive dhe demokraci parlamentare me Mbretëreshën si sovrane dhe Kuvendin e përbërë nga dy dhoma: Dhoma e Lordëve dhe Dhoma e Përfaqësuesve që ka 651 anëtarë të zgjedhur çdo pesë vite. Fuqia ekzekutive e Mbretëreshës mbështetet nga Qeveria e udhëhequr nga Kryeministri.

- Sovrani: Mbretëresha Elizabetë II (1952);
- Kryeministri: David Cameron (2010)
- Sipërfaqja tokësore: 241,590 km²;
- Popullata (2010): 61,284,806, me shkallë të rritjes prej 0.2%; shkalla e lindjes 10.6/1000; me shkallë të vdekshmërisë të të porsalindurve 4.7/1000; me jetëgjatësi prej 79.1; dhe me dendësi mesatare 246b/km²;



- Njësia momentare: Funta sterling
- Gjuhët zyrtare: gjuha Angleze, gjuha Uelshiane dhe gjuha Skote;
- Etniteti/raca (2001): 83.6% anglez, 4.9% Uelshian, 2.9% Irlandez verior, 2% të zi, 1.8% Indian, 1.3% Pakistanez, 1.2% të përzier dhe 1.6% të tjerë;
- Religjioni (2001): 71.6% të krishterë, 2.7% mysliman, 1.0% hindus, 1.6% të tjerë, dhe 23.1% të papërcaktuar;
- Ekonomia (2009): GDP \$2.149 bilion me \$35,200 për capita, me shkallë reale të rritjes prej 4.8%, me shkallë të inflacionit prej 2.1% dhe me shkallë të papunësisë prej 8.0%;
- Fuqia punëtore (2004): 30.07 milion nga të cilët 1.5% në bujqësi, 19.1% në industri dhe 79.5% në shërbime.
- Burimet natyrore: thëngjill, petroleumi, gazi natyror, gurët gëlqeror, hekuri dhe toka e punueshme;
- Eksporti (2009): \$351.3 bilion (fabrikate, lëndë djegëse, kemikalje, ushqim, duhan etj.);
- Importi (2009): \$473.6 bilion (fabrikate, makineri, lëndë djegëse, artikuj ushqimor etj.);

Çka u prezantua dhe çka u diskutua?

Vizita studimore u organizua nga CHwB, e cila për qëllim kryesor kishte njohjen me praktikat që aplikohen në MB në mbrojtjen, menaxhimin, promovimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Përmes takimeve dhe bisedave që u zhvilluan, u ofrua mundësia që për së afërmë të njoftohemi me situatën në sektorin e trashëgimisë kulturore në MB, në mënyrë që këshillat dhe përvojat e fituara të na shërbejnë për konsolidimin e situatës së trashëgimisë kulturore në Kosovë.

Organizimi i sektorit të trashëgimisë kulturore

Trashëgimia kulturore paraqitet si njëra ndër segmentet e rëndësishme të promovimit dhe zhvillimit në përgjithësi në MB. Sipas prezantuesve, mbrojtja dhe trajtimi i trashëgimisë kulturore realizohet nga dy subjekte të fuqishme: English Heritage dhe National Trust. E para është strukturë e Qeverisë Angleze që menaxhon me të gjitha objektet dhe zonat që janë në pronësi të shtetit (kryesisht kështjellat). Në aspektin organizativ një institucion i tillë i përgjigjet Departamentit të Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë tonë të kulturës. Ndërsa, National Trust është organizatë joqeveritare që mbulon territorin e Anglisë, Uellsit dhe Irlandës Veriore. Të dy organizatat funksionojnë në bazë të rregullave që nxirren nga shtetet përkatëse dhe janë përgjegjëse për menaxhimin e pasurive që disponojnë. P.sh. National Trust ka në pronësi të vetën më tepër se 400 site të njohura të trashëgimisë kulturore, të cilat me fanatizëm mbrohen dhe trajtohen nga një staf i përbërë prej profesionistëve të fushave të ndryshme. Menaxhimi i zonave kryesisht realizohet duke pas për bazë parimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm, që do të thotë shfrytëzim për nevoja ekonomike, duke i respektuar me përpikëri rregullat dhe normat e përcaktuara për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.



Aktualisht NT-ti ka një qarkullim vjetor finansiar prej më shumë se 400 milion F, burimet kryesore të të cilave janë të hyrat nga anëtarësimi (më shumë se 4 milion anëtarë); nga turizmi (vetëm Londrën e vizitojnë rreth 15 milion turistë ndërkombëtarë në vit); dhe një mekanizëm tjetër me rëndësi janë lotaritë kombëtare, një përqindje e konsiderueshme e të cilave i dedikohet mbrojtjes dhe trajtimit të duhur të trashëgimisë kulturore.

Një subjekt tjetër me rëndësi ndërkombëtare është International Trust Organization, me seli në Londër dhe New York. Aktiviteti kryesor i këtij asociacioni është aleanca dhe bashkëpunimi me organizatat e të gjitha shteteve të botës, që merren më çështjen e trashëgimisë kulturore. Një çështje me rëndësi që u përmend nga prezantuesja ishte parimi i "patjetërsueshmërisë" në bazë të të cilit, në disa objekte ose zona nuk munden as organet shtetërore të kenë ndikim për ndonjë ndryshim apo intervenim eventual. Dhe kjo është njëra nga arsyet kryesore, që qytetarët me lehtësi vendosin ti dhurojnë pronat e tyre, organizatave që merren me menaxhimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore.



Vizita në Fshatin Lacock

Fshati Lacock është njëri nga rastet tipike të trajtimit të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore, në të cilin të gjithë pjesëmarrësit u akomoduam për katër ditë me radhë.

Fshat mesjetar, i njojur për vlerat e tij të shumta të trashëgimisë kulturore, në të cilin jetojnë jo më shumë se 250 banorë rezident. Njëra nga veprimtaritë kryesore të fshatit është turizmi, dhe momentalisht të gjitha aktivitetet zhvillohen në drejtim të rritjes dhe përmirësimit të ofertës turistike. Natyrisht se të gjitha këto veprime bëhen nën mbikëqyrjen dhe menaxhimin e National Trust-it (në vitin 1944 i gjithë fshati është dhuruar nga familja Talbot) të bazuara në dispozitat ligjore që rregullojnë çështjen e trajtimit dhe shfrytëzimit të trashëgimisë kulturore në MB. Sfidë momentale për fshatin është mosha mesatare dhe numri i vogël i banorëve. Prandaj njëra nga politikat e NT-it është populimi i fshatit, duke ofruar kushte të favorshme për jetesë sidomos përfamiljet me fëmijë të vegjël. Një veprim i tillë theksohet të jetë garanci për mbarëvajtjen e aktiviteteve të planikuara përfshirë ardhmen e fshatit.

I gjithë fshati është zonë e mbrojtur e trashëgimisë kulturore, me disa objekte dhe zona që përfshinë ditë e më shumë po e zgjojnë interesin e vizitorëve. Disa nga objektet e restauruara me kujdes, sot shfrytëzohen si muze, salla të takimeve, zyra të ndryshme, dyqane dhe restorante ekskluzive, të cilat së bashku me bujtinat e shumta (p.sh. fjetja me mëngjes kushton 800-1500 Funta në një shtëpi ku mund të akomodohen maksimum 8 persona) paraqesin njërin nga burimet kryesore të të hyrave në fshat. Njëra nga shtëpitë e veçanta të fshatit ishte Shtëpia e gjuetisë e Mbretit Gjon e shekullit XIII, të cilën mbreti i atëhershëm e shfrytëzonte sa herë që vinte në këto anë përgjuejti. Sot shtëpia sikur edhe fshati është pronë e NT-it dhe shfrytëzohet si bujtinë dhe restoran qaji shumë ekskluziv.



Fig. Rrugët dhe objektet e Fshatit Lacock

Njëri nga objektet me rëndësi është Abacia e fshatit, një objekt mahnitës kishtar, me një arkitekturë stillesh të përziera, që dëshmon një histori të gjatë të ndikuar nga shumë rryma dhe teknika të ndërtimit. Në disa nga hapësirat e shumta të objektit janë xhiruar edhe disa nga skenat e filmit të njojur Harry Potter. Çmimi përfshirë angazhim nuk na u bë i njojur, me siguri ka qenë i lartë duke pasur parasysh se në një rast tjetër BBC ka paguar 6.000 funta në ditë, përfshirë shfrytëzimin e rrugës kryesore të fshatit.

Fig. Pamje të abacisë së fshatit Lacock



Një fakt tjetër me rëndësi për këtë fshat është zbulimi i fotografisë (procesi dhe teknologjia e prodhimit) që u realizua nga Fox Talbot në vitin 1845. Në muzeun me emrin e tij, janë të eksposuara mjetet dhe fotot e ndryshme nga jeta dhe veprimitaria e tij e bujshme. Disa nga hapësirat e këtij objekti sot shfrytëzohen për ekspozita dhe mbajtjen e kurseve të ndryshme të fotografisë.

Vizita në Uells

Me popullsi afersisht prej 3 milion banorësh, me sipërfaqe rreth 20 mijë km² dhe me paqartësi të theksuara politike, Uellsit dhe procesi i tyre i planifikimit hapësinor i rekomanduar nga IHS¹-i, është shfrytëzuar si praktikë e mirë për procesin tonë të hartimit të Planit Hapësinor të Kosovës.

Uellsit është njëri nga shtetet e MB-së që ende nuk e gjëzon pavarësinë e saj të plotë. Në vitin 1999 e ka fituar të drejtën për zgjedhje lokale, nga të cilat ka dalë parlamenti i parë kombëtar. Edhe përkundër kësaj aktualisht fuqia e parlamentit është e kufizuar në disa rregulla lokale, ndërkoq që për ligjet dhe rregullat tjera shtetërore është përgjegjëse Londra. Edhe përkundër këtyre vështirësive populli uelshian shquhet për krenarinë dhe sakrificën e tyre në mbrojtje të identitetit shtetëror. Gjuha uelshiane është njëra nga karakteristikat dalluese që ruhet dhe kultivohet me fanatizëm. Dëshmi tjetër e një tradite dhe historie të lashtë, është Kështjella mesjetare Caerphilly, si njëra ndër kështjellat më të mëdha në Evropën perëndimore. Janë disa faktor që ndikojnë në këtë epitet, sipërfaqja prej 1.2Ha e bënë kështjellën më të madhe në Angli pas kështjellës në Windsor. E rrëthuar me sasi të mëdha uji dhe forma e saj koncentrike e ndërtimit, paraqet objektin e parë të asaj kohe të ndërtuar dhe të planifikuar për nevoja ushtarake.



Fig. Kështjella mesjetare Caerphilly

Tjetër zonë interesante e vizitës tonë ishte St Fagan - Muzeu i Hapur i historisë kombëtare të Uellsit. Muze i cili tregon se si populli i Uellsit ka jetuar dhe punuar në kohëra të ndryshme që nga shenjat e para të ekzistencës së tij. Muzeu është i përbërë nga objekte që përfaqësojnë treva dhe kohëra të ndryshme të ndërtimit. Përmes shtigjeve të shenjëzuara mirë, mund të kalosh orë të tëra duke vizituar objekte, që në fakt paraqesin kopje të objekteve origjinale, të cilat për arsyen e ruajtjes dhe konservimit, janë demontuar dhe ndërtuar serish duke përdorë metodat e njëjta të ndërtimit të tyre original. Atraksion i veçantë i muzeut është fshati i keltëve, i periudhës së hekurit, që dëshmon mënyrën e jetesës para 2500 viteve. Objekti më i rëndësishëm i muzeut janë sarajet e mbretëreshës Elizabetë, dhe kopshtet e mëdha përreth tij. Ndërtimi i tij është realizuar gjatë shekullit të XVI-të dhe si i tillë paraqet objektin e vetëm origjinal në kuadër të muzeut. Muzeu është hapur për vizitorë në vitin 1948 (gjatë gjithë kohës është duke u ndërtuar), dhe që nga ajo kohë është njëra nga pikat më interesante të trashëgimisë kulturore të Uellsit.

¹ Institut holandez për studime të banimit gjatë viteve 2003-2007 ka qenë në përkrahje të sektorit të planifikimit hapësinor në Kosovë.

Sot, muzeu përpos vizitave të shumë turistëve, përdorët edhe për organizimin e takimeve dhe ahengjeve familjare, gjithashtu rekamandohet edhe si lokacion për xhirime dhe filmime të ndryshme dhe ngjarje tjera që kontribuojnë në vet-qëndrueshmërinë e muzeut.



Fig. Shtëpi e fshatit kelt



Fig. Shtëpi fshati e shekullit XVII-të



Fig. Sarajet e Mbretëreshës

Vizita në qytetin e Bath-it

Sipas një legjende, para 3000 viteve djali i vetëm i mbretit të atëhershëm sëmuret nga një sëmundje e vështirë dhe e pashërueshme lebrosa². Duke qenë se në atë kohë ishte e pamundur që mbreti të kishte një djalë të tillë, ai vendosi ta largojë përgjithmonë nga shtëpia. Djali i braktisur, për ekzistencën e tij fillojë të merret me kultivimin dhe rritjen e derrave, të cilët gjithashtu u sëmurën nga e njëjtë sëmundje. Në një situatë të tillë, ishte balta që ndodhej aty pran, ajo që i ndihmoj derrave të shërohen, nga e cila edhe djali i mbretit u shërua me sukses. Dhe kështu, djali i shëruar u kthyte tek babai nga i cili trashëgojë mbretërinë, ndërsa balta dhe vendi ku ndodhej ajo u shpallën të shenjta.

² Lebroza – sëmundje ngjitëse dhe vdekjeprurëse e kohës;

Besohet se legjenda flet për të njëjtën zonë, në të cilën sot ndodhet qyteti i Bathit që njihet për burimet e shumta të ujërave termal³. Pas pushtimit romak⁴ burimet u shndërruan në terme⁵ shëruese, një pjesë e të cilave edhe sot përdoret për të njëtin qëllim. Për vizitorët është e patejkalueshme vizita e organizuar në mënyrë të shkëlqyeshme, e njërs nga këto terme, dhe përfjetimi i hapësirave shumë origjinale, që dëshmojnë për jetën shumë luksoze të para afersisht 2000 vitesh.



Fig. Pamje e brendshme e Termes - Hamamat Romak

Qytetit i Bathit, pjesa më e madhe e tij, sot është trashëgimi botërore dhe nën mbrojtje të UNESCO-s. Si i tillë, veprimitaria kryesore e tij është turizmi (rreth 400 mijë turistë në vit) - nga i cili jeton dhe për të cilin angazhohen dhe veprojnë të gjitha strukturat relevante. Pjesa më e madhe e objekteve i takon arkitekturës Gjorgjiane⁶, që me shumë kujdes janë ndërtuar nga arkitektët e kohës, nga të cilët më i njohuri është John Wood dhe djali i tij. Objektet tipike të kësaj arkitekturë janë Royal Crescent (Gjysmërrethi mbretëror) dhe Sheshi i Mbretëreshës me objektin rrëthor. Dy objektet, janë objekte banimi me një numër të kufizuar të banesave, që kryesisht janë me sipërfaqe të madhe. Disa nga këto banesa sot janë pronë e figurave të njohura botërore, nga të cilat e mbajta në mend vetëm aktorin Nicolas Cage.



Fig. Pamje e objekteve Gjysmërrethi mbretëror dhe Sheshi i Mbretëreshës

³ Janë të njohur tre burime të mëdha termale, që përbajnë në vete më tepër se 40 minerale me radioaktivitet shumë të ulët;

⁴ Shekulli i parë i erës sonë;

⁵ Terme Romake – ose Hamamet Romake që dallojnë nga ato Turke edhe përfaktin se ato në të njëjtën kohë janë shfrytëzuar nga të dy gjinjë;

⁶ Arkitekturë që është përdorë në shek. XVIII dhe është quajtur me emrin e mbretërvë të asaj kohe Mbreti Gjorgj I, II, II dhe IV. Karakteristika themelore janë shtëpi të thjeshta dhe jo shumë të larta (1-2 kate) me simetri precize dhe të theksuar të ndërtimit. Dera e hyrjes zakonisht është në qendër, me fasadë të pasur në pjesën e përparme në të cilën zakonisht dominojnë shtyllat dhe dritaret drejtëkëndëshe, të shpërndara në mënyrë simetrike;

Nga të gjitha objektet që dallohet më së shumti është Abacia e Bathit. Objekti është dëshmi e një historie të gjatë më tepër se një mijë vjeçare, e cila i është nënshtuar ndikimeve të ndryshme religjioze dhe fizike, të cilat mund të vërehen lehtë edhe nga vizitorët e thjeshtë. Disa ndryshime të rëndësishme janë bërë nga Sir George Gilbert Scott (punët u realizuan nga 1864 deri 1874), i cili në mes tjerash tavanin e drurit e ndryshojë në tavan prej gurit, që sot ka një pamje mahnitëse.



Fig. Pamje e Abacisë së qytetit të Bathit (fasada kryesore dhe tavani i objektit)

Vizita në Stonehenge dhe Avebury⁷

Stonehenge⁸ është njra nga trashëgimitë më të njoitura botërore dhe sipas shumë njoħesve shenja mbrojtëse e trashëgimisë kulturore në Mbretërinë e Bashkuar. Objekti paraqet një grumbull të gurëve të renditur në rrathë koncentrik, që besohet se janë realizuar afersisht 2000 deri në 3000 vjet para erës sonë. Besohet se gurët e rëndë (më i rëndi 40 tonë) janë marrë dhe sjellë nga një zonë e lagët afersisht 250 km. Të vendosur në mënyrë vertikale dhe horizontale, dhe të gdhendur me përpikëri, paraqesin njërin ndër objektet e para arkitektonike. Mënyra dhe qëllimi i ndërtimit kanë qenë dhe janë ende objekt i studimit për shumë shkencëtarë. Nuk ekziston ndonjë teori e saktë e ndërtimit, por sipas shumicës më e përaferta ndërlidhet me teorinë sipas të cilës, objekti është ndërtuar dhe përdorë për qëllime fetare. Edhe kompleksi në Avebury, në aspektin e trashëgimisë ka të njëjtën rëndësi. 180 gurët e pa gdhendur të peshave të ndryshme, që qëndrojnë në pozitë vertikale dhe të renditur në një perimetër prej 1.3 km, paraqesin gjithashtu njérën nga enigmat ende të paspjegueshme të teknikës së ndërtimit.



Fig. Stonhange



Fig. Avebury

⁷ Dy objektet janë raste tipike të menaxhimit të trashëgimisë Kulturore në MB. Sipas rregullave gurët janë pronë dhe menaxhohen nga English Heritage ndërsa rrethina është pronë dhe menaxhohet nga National Trust-i;

⁸ E shpallur në listën e UNESCO-s si Trashëgimi botërore në vitin 1986;

Vizita në Londër

Londra është kryeqyjeti i Anglisë dhe i Mbretërisë së Bashkuar, e cila shtrihet në dy brigjet e lumit të lundrueshëm Temza. Shënimet tregojnë se fillimet e para të jetesës datojnë qysh para 2000 vitesh, kur edhe u themelua nga pushtuesit romak me emrin Londinium. Qyteti i Londrës me një sipërfaqe që përfshinë një rreth me rreze afërsisht 1.5 km, është pjesa antike e Londrës. Në të janë të vendosura pjesa më e madhe e objekteve të kësaj kohe, që dëshmojnë për një traditë të lashtë të funksionimit të shtetit në të gjitha segmentet e tij. Sipas informatave, Londra sot përfqaqëson zonën më të madhe urbane (zona metropolitane) në të gjithë Evropën e Bashkuar, në të cilën jetojnë afërsisht 12 milion banorë. Në vitin 2012 Londra u bë nikoqir i Lojëra Verore Olimpike, në të cilat morën pjesë më tepër se 10.000 atletë nga më se 200 vende të botës. Njëra nga fushat e rëndësishme të ekonomisë edhe në Londër është fusha e turizmit. Sot, Londra është qendër e një trashëgimie të vjetër historike dhe kulturore, qendër administrative dhe ekonomike me ndikim në botë, qendër e më shumë se 40 universiteteve me renome botërore, që së bashku dëshmojnë për një traditë të lashtë të qytetërimit jo vetëm në ishull por në të gjithë Botën.



Fig. Sheshi i njohur – Trafalgar Square



Fig. Ura e njohur - Tower Bridge



Fig. Ndërtesa e njohur e parlamentit të MB-së – Palace of Westminster⁹

⁹ Ndërtesa e Parlamentit ka 1200 hapësira (zyre) dhe më tepër se 3km korridore;



Cilat janë disa nga përfundimet dhe rekomandimet:

- Funksionimi i sistemit dhe strukturës që merret me trajtimin e trashëgimisë kulturore në MB, duhet të shërbejë si argument për konsolidimin e sistemit dhe strukturës tonë të Trashëgimisë Kulturore;
- Trashëgimia kulturore si fushë me të gjitha segmentet e saja, është element shumë me rëndësi për zhvillimin ekonomik të një vendi. Prandaj, rekomandohet që të futet në priorititetet dhe agjendën e qeverisë qendrore dhe lokale;
- Në këtë drejtim: funksionimi i një organizate siç është National Trust-i, mund të jetë njëra nga zgjidhjet e mira praktike edhe në rrethanat e Kosovës;
- Përcaktimi dhe definimi i qartë është parakushti themelor, për trajtimin adekuat të trashëgimisë kulturore me të gjitha komponentët e saja;
- Promovimi i trashëgimisë kulturore është njëri nga instrumentet kryesore. Në të gjitha rastet e vizitës u dëshmuia nevoja për ngritjen e nivelit të promovimit të trashëgimisë kulturore në favor të zhvillimit të turizmit;
- U konstatua se njëri nga burimet kryesore financiare janë Lotaritë kombëtare, një përqindje e konsiderueshme e këtyre mjeteve i dedikohet fushës së trashëgimisë kulturore. Prandaj rekomandohet që, një praktikë e tillë të aplikohet edhe në vendin tonë.
- Rasti i Fshatit Lacock dhe Qytetit Bath janë dëshmitë kryesore që tregojnë fuqinë e trajtimit të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore;
- Në të gjitha rastet u konstatua se, veprimet në fushën e trashëgimisë kulturore bëhen në koordinim me të gjitha strukturat relevante dhe në pajtim të plotë me rregullat në fuqi;
- Është shumë e nevojshme të insistojmë në ngritjen e vazhdueshme të vetëdijes për ruajtjen e TK në të gjitha nivelet;
- Besoj se, për të gjithë duhet me qenë shumë e rëndësishme që të gjejmë mënyrën e duhura, që përvojën e fituar ta bartim në institucionet tona përkatëse;

Luan Nushi, drejtor

Instituti për Planifikim Hapësinor

Ajencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Prishtinë, 26.11.2012

